



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr. 12/2026

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hajriz Hoti kryesues, Ramush Bardiqi dhe Bujar Muzaqi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arbër Vukli nga Peja, paraqitur kundër Ardit Gërvalla, anëtar i Kuvendit Komunal në Pejë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të dezinformimit publik dhe publikimit të dokumenteve zyrtare, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.02.2026, merr këtë;

V E N D I M

Hedhet poshtë e palejuar ankesa e parashtruar nga Arbër Vukli nga Peja, Anr.12/2026, e datës 18.02.2026, e paraqitur kundër Ardit Gërvalla, anëtar i Kuvendit Komunal në Pejë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të dezinformimit publik dhe publikimit të dokumenteve zyrtare.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 18.02.2026 ka pranuar ankesën Anr.12/2026 nga Arbër Vukli, i cili thekson se kjo ankesë paraqitet për shkak të publikimit në rrjetin social Facebook të një dokumenti të manipuluar/falsifikuar nga subjekti kundër të cilit paraqitet ankesa, veprim i cili përbën dezinformim publik dhe cenim të integritetit të procesit të mandatimit/zëvendësimit në Kuvendin Komunal. Parashtruesi i ankesës thekson se Komuna ka nxjerrë një dokument zyrtar lidhur me çështjen e zëvendësimit, i cili përmban vulën e kryesuesit dhe numrin përkatës të protokollit. Sipas parashtruesit të ankesës personi kundër të cilit paraqitet ankesa ka publikuar një version të ndryshuar të këtij dokumenti duke ndryshuar përmbajtjen dhe konkretisht emrin e zëvendësuesit, hequr numrin e protokollit, mos përfshirë vulën zyrtare. Parashtruesi i ankesës thekson se publikimi i këtij dokumenti të manipuluar është bërë në kohën kur ai ka qenë në pritje të një vendimi zyrtar nga Komuna, dhe ka pasur për qëllim krijimin e një perceptimi të rremë në opinionin publik, rritjen e presionit ndaj tij dhe ndikimin në procesin institucional. Ky veprim sipas parashtruesit të ankesës përbën dezinformim publik, pasi paraqet si autentik një dokument që është i ndryshuar në përmbajtje dhe i paplotë në elementet formale zyrtare, duke mashtruar publikun lidhur me një proces që është në zhvillim. Andaj sipas parashtruesit të ankesës veprimet e mësipërme përbëjnë cenim të integritetit dhe besueshmërisë së procesit zgjedhor dhe të administrimit të mandateve,

dezinformim publik me qëllim ndikimin në një proces që buron nga rezultati zgjedhor, paraqitje të rreme të dokumentacionit zyrtar, dhe elemente të veprës penale të falsifikimit të dokumentit dhe përdorimit të dokumentit të falsifikuar, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. I njëjti thekson se duke qenë se çështja lidhet drejtpërdrejt me mandatin/zëvendësimin që rrjedh nga procesi zgjedhor, kërkon nga PZAP që ta trajtojë këtë rast si shkelje që cenon rregullsinë dhe integritetin e procesit zgjedhor në nivel lokal, dhe i propozon PZAP-it që të pranojë këtë ankesë si të bazuar, të konstatojë se publikimi i dokumentit të manipuluar përbën dezinformim publik dhe cenim të integritetit të procesit zgjedhor, të shqiptojë masat përkatëse ndaj personit kundër të cilit paraqitet ankesa, dhe të vlerësojë referimin e rastit në organet kompetente për ndjekje penale.

Si dëshmi ka bashkangjitur dokumentin zyrtar të komunës me vulë dhe numër protokolli, screenshot i publikimit në facebook nga subjekti në fjalë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se **Ankesa është e pa lejuar**.

Për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës, paneli iu referuar Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119 paragrafi 1 dhe 3, me të cilin është përcaktuar se “Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, ndërsa PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.” Ndërsa kundër të cilave vendime të KQZ-së mund të ushtrohet ankesë është specifikuar me nenet, 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1, si dhe ato të cilat janë të përcaktuara në nenin 9 dhe parag, 5 të këtij neni, të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin është përcaktuar “Personi fizik ose juridik i cili ka interes ligjor mund të parashtrojë ankesë në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, të drejtat e të cilit janë shkelur sipas dispozitave të LQP-së ose rregullave zgjedhore.

Rrjedhimisht, parashtrimi i ankesës nga Arbër Vukli me pretendimin se Ardit Gërvalla anëtar i kuvendit komunal në Pejë nga subjekti politik LVV, ka bërë dezinformim, cenim të integritetit të procesit të zëvendësimit duke manipuluar dhe publikuar dokumente zyrtare të Komunës së Pejës, Paneli ka gjetur se këto pretendime nuk hyjnë në kompetencat e ankesave të cilat mund të parashtrohen në PZAP, pasi që nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se pretendimet ankimore të kësaj natyre bien në kompetencat e fushëveprimit të PZAP.

Sipas vlerësimit të Panelit, nga interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe pretendimeve ankimore të ankuesit nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se mund të parashtrohet ankesë e kësaj natyre në PZAP.

Neni 115 LQP parasheh se, PZAP është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore. Paneli vlerëson se ankesa në fjalë është e palejuar ngase me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me Rregullat Zgjedhore, PZAP nuk ka

kompetencën për të vendos sanksionime apo marrjen e masave tjera ligjore për shkeljet e pretenduar të ankuesit të kësaj natyre.

Prandaj, nga arsyet e theksuar më lartë, në pajtim me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, si dhe nenit 115 paragrafi 1, dhe nenit 119, të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën të pa lejueshme.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.12/2026 më datën 20.02.2026



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzetetetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.